

**Nr. Prot. 063/B/19**

## VENDIMI Nr. 1399

Për

### **Caktimin e kodit MNC për përdorim nga Operatorin Virtual Dukagjini Telecommunications LLC**

Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1.26), nenit 9 paragrafi 1), nenit 10 paragrafi 12), nenit 59, nenit 79 paragrafi 1) dhe 2) të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*); Rregullores nr.32 për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës (*Ref. Nr. Prot. 038/B/17; dt.16/06/2017*), nenet 4), 5), 7), 8) dhe 21.4 (*tutje referuar si - Plani i Numeracionit*); Pika 3.2) të Planit të Migrimit i kodeve ekzistuese +377, +381 dhe +386 në kodin telefonik shtetëror +383 të Republikës së Kosovës (*tutje referuar si – Plani i Migrimit*) të miratuar me Vendimin Nr.935 (*Ref. Nr.Prot.011/B/17, dt.23/02/2017*); Nenet 3.3 dhe 4.9 të Kornizës Kornizës së ndryshuar për Operatorët e Rrjetës Virtuale Mobile (*Ref. Nr.Prot. 110/08; Korniza MVNO*); Rekomandimit E.212 të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve (*tutje referuar si – ITU*); Aplikacionit për kodin e rrjetit mobil (MNC) të operatorit Dukagjini Telecommunications LLC. (*tutje referuar si – Dukagjini*) të datës 15 Maj 2019 (*Ref. Nr.Prot.338/2/19*); në përputhje me dispozitat e nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - ARKEP ose Autoriteti*), Bordi i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Kreshnik Gashi, Kryetar,
- 2) z. Nijazi Ademaj, Anëtar,
- 3) z. Hazir Hajdari, Anëtar,
- 4) z. Bahri Anadolli, Anëtar,

në mbledhjen e 40-të të mbajtur më datë 24 Qershor 2019, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe raportit të Departamentit për Komunikime Elektronike (DKE), unanimisht morri këtë:

## V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e **Dukagjini** për caktimin e kodit si në vijim:

- **Kodin MCC MNC: 221 07**

II. Implementimi i kodit MNC duhet të bëhet me marrëveshjen e të dyja palëve, pra MNO-MVNO, në të kundërtën Vendimi nuk do të prodhojë efekt juridik.

III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Neni 4 paragrafi 26 i i Ligjit specifikon se: *“Resurse të komunikimeve elektronike – radio-frekuencat (kanalet), numrat telefonikë dhe identifikuesit tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike, të tilla si shenjat e radio- thirrjeve, resurset orbitale, duke përfshirë edhe pozitën në një orbitë gjeostacionare dhe burimet tjera të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të komunikimeve elektronike, për përdorimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, ose radio-pajisjeve, apo pajisjeve fundore dhe për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike*

Neni 10 paragrafi 12 i Ligjit specifikohet se: *“Autoriteti Menaxhon resurset e fundme – spektrin e radio-frekuencave dhe hapësirën e numeracionit në komunikimet elektronike”.*

Po ashtu neni 21.4 i Planit të Numeracionit specifikon se blloqet, të cilat do të jenë në dispozicion për t’u caktuar operatorëve për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile do të fillojnë nga MCC MNC: 221 01 deri 221 09. Në rast se paraqitet nevoja për kode shtesë, Autoriteti mund të caktoj kodet nga 221 10 e tutje.

Pika 3.2) e Planit të Migrimit specifikon se ARKEP në përputhje me Rekomandimin ITU-T E.212 si administrues i resurseve numerike ka përgjegjësinë për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për ndarjen dhe revokimin e kodeve MNC. Po ashtu pika 3.2.1) e Planit të Migrimit specifikon se ARKEP rezervon të drejtën të caktoj një kod tjetër nga ai i kërkuar nga ai i kërkuar nga aplikuesi ose të refuzoj në tërësi aplikacionin.

Operatori Dukagjini Telecommunications LLC (D3Mobile) më datë 15/05/2019 ka dorëzuar aplikacionin (Ref. Nr.Prot.338/2/19) për marrjen e kodit MNC: 07.

Neni 3.3) i Kornizës për MVNO specifikon se *“MNO-të dhe MVNO-të duhet të jenë të lira që të negociojnë modelin, i cili më së miri ua plotëson interesat dhe strategjitë biznesore”.* Më tutje, Neni 4.9) i Kornizës për MVNO specifikon se *“MVNO-të duhet që t’i lejohet që të bëjë marrëveshje interkoneksioni dhe roamingut me operatorët tjerë në përputhje me ligjin dhe rregulloret tjera që janë në fuqi.”*

Pas shqyrtimit të aplikacionit të referuar më lartë, Rekomandimeve të ITUsë dhe CEPT/ECC, marrë parasyshë faktin se ARKEP konsideron se kodet 01 deri 05 duhet të rezervohen për MNO.

Prandaj, me qëllim të krijimit të kushteve më të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike përmes implementimit të mekanizmave të përshtatshëm për mbrojtjen e konkurrencës, eliminimit të pengesave në orientimin e trafikut, si dhe menaxhimin më adekuat të resurseve të kufizuara numerike,

Andaj, Bordi i ARKEP ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit.

**Prishtinë, 28/06/2019**

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi**  
**Kryetar i Bordit**

**Aktvendimi i dërgohet:**

- Operatorit Dukagjini Telecommunications LLC;
- Departamentit për Komunikimet Elektronike (DKE);
- Departamentit Ligjor (DL);
- Arkivës së Autoritetit